

TAKIMI I PARË 2024 - KOMITETI SEKTORIAL I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

Mbledhja e Komitetit Sektorial të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit u mbajt më datë **11.04.2024**.

Mbledhja u fokusua në diskutimin dhe validimin e dy dokumenteve, konkretisht dy standardeve të kualifikimeve profesionale: **“Inxhinieri Informatike Software-ike”** dhe **“Siguri Kibernetike”**.

Anëtarëve iu sqarua se, standardi i profesionit **“Teknikë të inxhinierisë software-ike”**, për të cilin anëtarët kishin dhënë rekomandime dhe komente në mbledhjen e mëparshme, ishte diskutuar me palën austriake dhe ishte dakordësuar një draft final, i cili përputhej me standardet që homologët zhvillonin në Austri. Sekretariati Teknik prezantoi ndryshimet e bëra në dokument, nisur nga propozimet e mëparshme të anëtarëve. Anëtarët miratuan ndryshimet e bëra dhe draft-in final, por rekomanduan ndryshimin e emërimit të standardit të profesionit si: **“Teknik i Inxhinierisë Informative”**. Propozimi u reflektua në draft-in final dhe më pas u vijua me diskutimin e standardit të kualifikimit. Sekretariati shpjegoi se, standardi i kualifikimit organizohej në njohuri, shprehi dhe kritere vlerësimi, të cilat shërbenin si bazë për ndërtimin e kurrikulës. Sekretariati prezantoi të gjitha rubrikat e standardit të kualifikimit profesional dhe në përfundim të diskutimeve, standardi u miratua pa asnjë ndryshim.

Në vijim u kalua tek prezantimi i standardit të kualifikimit profesional: **“Siguria kibernetike”**. Sekretariati evidentoi se, grupi hartues kishte vendosur që kualifikimi **“Siguria kibernetike”** të kishte një kohëzgjatje dy vjeçare dhe të mund të ndiqej nga persona që kishin përfunduar nivelin IV të KSHK-së për TIK, si dhe nga ata që kishin përfunduar minimalisht nivelin IV të KSHK-së për arsimin e përgjithshëm dhe që kishin të paktën një vit eksperiencë pune në fushën e TIK. Këto vendime u miratuan nga anëtarët e KS.

Sekretariati prezantoi të gjitha rubrikat e standardit të kualifikimit profesional dhe në përfundim të diskutimeve, standardi u miratua pa asnjë ndryshim.

Vendime të marra nga mbledhja:

- U bë validimi i standardit të kualifikimit **“Siguri Kibernetike”**.
- U bë validimi i standardit të profesionit **“Teknik i Inxhinierisë Informative”**.
- U bë validimi i standardit të kualifikimit **“Inxhinieri Informatike Software-ike”**.